

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen bashkëpunëtorit profesional Visar Zeqiri, në lëndën penale ndaj të pandehurit V. Sh., nga fsh. B. i Z. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr. *numri*, të dt 28.06.2016, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesen për dhënien e urdhrit ndëshkimor me dt. 05.08.2016 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr. *numri*, të dt 14.01.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit:

V. Sh., nga i ati H., i lindur më dt. *data e lindjes*, me vendbanim në fsh. B. i Z. K. L., me nr. personal *numri*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

Me datë 13.11.2015, rreth orës 11:30, në rrugën L.-B. i Z., duke drejtuar automjetin e tipit “Ford Courier”, me targa *numri i targës*, nga pakujdesia duke menduar se deri te aksidenti nuk do të vijë, i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me nenin 42dhe 62.2 të LSKRR-së, ka rrezikuar trafikun publike dhe ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, ashtu që në mënyrë të pasigurt ka nrërmarrë veprimin e kthimit në të majtë për t’u kyçur nga rruga dytësore në rrugën kryesore dhe nuk i ka lejuar përparësi kalimi ngasësit të automjetit “VW-Golf” 19E, me targa *numri i targës*, të cilin e drejtontë Xh. B., me ç’rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, pëson i dëmtuari T. Z..

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform të dispozitave të lartcekura dhe dispozitave të neneve, 1, 2, 3, 4, 7, 17, 41,42, 43, 46, 73, 378 par 6 lidhur me par 1 të KPRK-së dhe neneve 493, 495 si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e,

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

I dëmtuari: T. Z. nga fsh. V. K. L., udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt gjyqësore.

DETYROHET i akuzuari në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajë, shumën prej 60.88-€, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.nr. *numri*, të dt 28.06.2016, e ka akuzuar të pandehurin V. Sh. nga fsh. B. i Z. K. L., për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe me datën 14.01.2016, ka kërkuar që të pandehurit ti shqiptohet urdhër ndëshkimor – dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal të dt. *numri*, Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. V. K., të dt. *data*, dhe Mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit R. B., të dt. *data*, dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës, në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoji si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me prova të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 (tri) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.1. dhe 2.6 të KPPK-së.

Udhëzimi i të dëmtuarit për kërkesën pasurore juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore u bazua në nenin 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN
P.nr.453/16, me dt.05.08.2016

Bashkëpunëtori Profesional

Visar Zeqiri

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.